



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KRYETAR**

Nr 6887 prot.

Shkodër, me 28.03.2025

Lënda: Dërgohet për shqyrtim projekt-vendimi dhe relacioni


KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Të nderuar këshilltarë,

Bashkëngjitur Ju dërgojmë për shqyrtim relacionin dhe projekt-vendimin “PËR NJË SHITESË NE VKB NR. 76, DATË 19.12.2024 “PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2025 DHE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESEM PËRFUNDIMTAR 2025-2027 TË BASHKISË SË SHKODRËS.” TË NDRYSHUAR DHE DETAJIM TË FONDEVE SIPAS AKTIT NORMATIV NR. 5 DATË 19.12.2024 TË MINISTRISË SË FINANCAVE

Duke ju uruar punë të mbarë.

Me respekt,



Pr/Vendim: 2 fletë

Relacion: 4 fletë

Shkresa nr. 17526/2: 2 fletë

Fisha: Krijimin e kushteve për pushuesit në plazhet publike të menaxhuar



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

Nr 6884/1 prot.

Shkodër, me 28.03.2025

PROJEKT-VENDIMI

Nr. _____, datë _____.2025

**“PËR NJË SHITESË NE VKB NR. 76, DATË 19.12.2024 “PËR MIRATIMIN E
BUXHETIT TË VITIT 2025 DHE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM
PËRFUNDIMTAR 2025-2027 TË BASHKISË SË SHKODRËS.”, TË NDRYSHUAR DHE
DETAJIM TË FONDEVE SIPAS AKTIT NORMATIV NR. 5 DATË 19.12.2024 TË
MINISTRISË SË FINANCIVE**

Këshilli i Bashkisë Shkodër, sot me datë ____/____/2025, në mbështetje të nenit 54 germa ‘dh’ të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “ Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar; ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 ”Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar; ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar; ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar; Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”; të ndryshuar; Udhëzimit Plotësues të Ministrisë së Financave nr.2, datë 24.01.2025 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025” VKM Nr.649, datë 16.10.2024 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”; VKB nr.76, datë 19.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë së Shkodrës”, i ndryshuar; shkresa e Ministrisë së Financave nr.17526/2.prot, dt.23.12.2024 “Mbi zbatimin e Aktit Normativ nr. 5, datë 19.12.2024” pas shqyrtimit të relacionit nr.____.prot, datë _____ të administratës së bashkisë Shkodër, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Shkodër,

V E N D O S I:

1. Miratimin e shtesës së planit të buxhetit të Bashkisë Shkodër prej 40,000,000 lekë për krijimin e kushteve për pushuesit në plazhin publik të menaxhuar. Burim financimi është fondi shtesë i transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme sipas shkresës nr. 17526/2 Prot. dt. 23.12.2024 “Mbi zbatimin e Aktit Normativ nr. 5, datë 19.12.2024” të Ministrisë së Financave. Ky aktivitet do të përfshihet në programin P.AC141.Q3.O1.A15 “Krijimin e kushteve për pushuesit në plazhet publike të menaxhuara” përkatësisht transfertë 40,000,000 lekë Artikulli 604, për Sh.a. me NIPT M369240030, si shtesë kapitali, sipas fishës bashkëngjitur:
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.



Zv. Kryetar

Alban Pecka

Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit
Financiar

Arta Hoxha
(Pa prezantim e fardes)

Drejtoria e Juridike

B. Durrës

Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të
territorit

Vitina Dreshi

Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të
Qëndrueshëm Ekonomik

Behar Meme

Drejtoria e Përgjithshme Juridike, Burimeve
Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse

Le-3 Durrës

Drejtoria e Turizmit

Renato Durrës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM EKONOMIK
DREJTORIA E TURIZMIT

Nr _____ prot.

Shkodër, me _____._____.2025

RELACION

**“PËR NJË SHITESË NE VKB NR. 76, DATË 19.12.2024 “PËR MIRATIMIN E
BUXHETIT TË VITIT 2025 DHE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM
PËRFUNDIMTAR 2025-2027 TË BASHKISË SË SHKODRËS.” TË NDRYSHUAR DHE
DETAJIM TË FONDEVE SIPAS AKTIT NORMATIV NR. 5 DATË 19.12.2024 TË
MINISTRISË SË FINANCAVE**

Drejtuar: Këshillit Bashkiak, Shkodër.

Të nderuar këshilltarë,

Bashkia Shkodër, për zonën e Velipojës, ka një plan ambicioz për rritjen e sipërfaqeve publike dhe krijimin e mundësive për çdo vizitor që dëshiron të shfrytëzojë këto hapësira me cilësi të mirë. Velipoja është një pasuri e rëndësishme natyrore e të gjithë bregdetit Shqiptar dhe ka nevojë të ruhet por dhe të zhvillohet në një mënyrë të qëndrueshme, duke dhënë shërbimet e duhura për vizitorët e shumtë. Sipërfaqja e madhe e plazheve në Velipojë kërkon dhe ndryshimet ligjore për menaxhimin e tyre kërkojnë krijimin e kushteve për pushuesit në plazhin publik të menaxhueshëm. Kjo do të sjellë një rritje të aksesit për pushuesit, duke mobiluar këto plazhe publike, menaxhuar dhe administruar ato duke filluar kështu një aktivitet të ri të menaxhimit të hapësirave publike të administruar nga një ent publik. Ky plan është pjesë e një përpjekjeje më të gjerë për menaxhimin dhe administrimin e këtyre hapësirave publike, që përfshin investime për implementimin e ndryshimeve ligjore që synojnë përmirësimin e shërbimeve dhe kushteve për pushuesit duke kontribuar në zhvillimin e zonës si një destinacion turistik tërheqës. Për të siguruar që këto hapësira të funksionojnë në mënyrë efikase dhe të ofrojnë kushte të përshtatshme për pushuesit, Bashkia Shkodër ka parashikuar disa hapa kyç për krijim të kushteve të përshtatshme për funksionim të këtyre plazheve:

Rritja e Sipërfaqeve Publike:

Bashkia planifikon të zgjerojë dhe ruajë sipërfaqet e plazheve dhe hapësirave publike që do të jenë në dispozicion të pushuesve. Ky zgjerim do të mundësojë një shpërndarje më të mirë të vizitorëve dhe do të kontribuojë në uljen e ngarkesës në disa zona të plazhit, duke krijuar më shumë hapësirë dhe mundësi zgjedhjeje për pushuesit .

Krijimi i Kushteve të Përshtatshme për Pushuesit:

Investimet do të përfshijnë krijimin e kushteve të përshtatshme për pushuesit, duke përfshirë vendosjen e çadrave dhe shezlonëve, pedanave të aksesit, shërbime higjienike të pastra, hapësira për aktivitetet e ndryshme dhe infrastrukturë për sigurinë e pushuesve.

Administrimi dhe Menaxhimi Efikas:

Në kuadër të ndryshimeve ligjore, Bashkia Shkodër është duke u përgatitur për administrimin dhe menaxhimin e plazheve të cilat në zbatim të neni 4 pika 6 të VKM Nr. 649, datë 16.10.2024 “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit” do të jenë në menaxhim të Bashkisë. Ky proces do të përfshijë gjithashtu një plan të detajuar për mbikqyrjen dhe administrimin e hapësirave, duke siguruar që plazhet të mbeten të pastra, të sigurta dhe të ofrojnë shërbime cilësore. Sipas të dhënave të ecures së aplikimeve pranë AKB dhe miratimit të kërkesave për stacione plazhi private, verëhet që do të ketë stacione private për të cilat nuk do të lidhet kontratë me privatë dhe në zbatim të nenit 4, pika 6 të VKM së sipër cituar do të jenë në administrim/menaxhim të Bashkisë Shkodër. Kjo bën që në bazë të fondeve të disponueshme të bëhet planifikimi i nevojës për administrim të këtyre plazheve, **dhe me fondet në dispozicion** të buxhetit të Bashkisë Shkodër përllëgatitet të kemi në administrim/menaxhim të parcelave të plazheve për të cilat nuk do të lidhet kontratë. Kjo do të përfshijë vendosjen e çadrave, shezlonëve, pedanave të aksesit, tualete publike, si dhe shpenzime për administrim të këtyre hapësirave (staf) në mënyrë që shërbimi i plazhit për pushuesit të jetë i sipas kërkesave të pushuesve.

Përgatitja për Sezonin Turistik:

Me afrimin e sezonit turistik, është e rëndësishme që të fillojnë organizimi dhe përgatitjet, duke përfshirë mirëmbajtjen e infrastrukturës ekzistuese, si dhe shtimin e mundësive për shërbime të reja dhe përmirësimin e kushteve të sigurisë dhe komoditetit për të ofruar një përvojë pozitive për pushuesit.

Ky plan do të mundësojë që Velipoja të vazhdojë të rritet si një destinacion turistik atraktiv, duke ofruar kushte moderne dhe të përshtatshme për të gjithë vizitorët që zgjedhin këtë zonë për pushimet e tyre. Kjo do të kërkojë një strukturë menaxhuese të specializuar për këto hapësira që do të ofrojnë shërbime për pushuesit. Ndryshimet ligjore në lidhje me administrimin e plazheve private dhe publike të menaxhuara kërkojnë që Bashkia Shkodër të zbatojë një sistem të ri menaxhimi që të përputhet me normat dhe kërkesat ligjore të përcaktuara, duke siguruar që këto hapësira të shfrytëzohen në mënyrë të qëndrueshme dhe të sigurta.

Për këtë duhet të kemi një strukturë menaxhuese dhe me kapacitete financiare që mund të administrojë hapësirat e plazhit dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve të nevojshme për pushuesit. Kjo do të përfshijë krijimin e kushteve për pushuesit në plazhin publik të menaxhueshëm dhe administrimin e çadrave dhe shezlongeve, pedanave të aksesit, pastrimit, sigurisë, tualeteve informacionit për pushuesit, etj.

Kjo është një mundësi e shkëlqyer për Bashkinë Shkodër për të zhvilluar më tej turizmin dhe për të ofruar kushte të përshtatshme për pushuesit, duke kontribuar në zhvillimin ekonomik.

Bashkia Shkodër ka në pronësi të saj 100% sh.a. me NIPT M36924003O, e cila me rritjen e kapaciteteve të saj mund të operojë në ushtrimin e funksionit të menaxhimit dhe administrimit të këtyre hapësirave publike të menaxhueshme të plazhit. Kjo do të bëjë që të kemi të njëjtin shërbim në të gjitha hapësirat publike të menaxhuara të plazhit.


Bashkia Shkodër përmes Sh.a. me NIPT M36924003O do të krijojë të gjitha kushtet e përshtatshme për sigurim të aksesit të publikut në shërbimet e ofruara nga një hapsirë plazhi si vendosja e shezlongeve, çadrave, rampave të aksesit etj.

Në vijim të shkresës nr. 17526/2 të Ministrisë së Financave “Mbi zbatimin e Aktit Normativ nr. 5 datë 19.12.2024, Bashkisë Shkodër i është akorduar fondi prej 68,819,838 lekë si transfertë e pakushtëzuar e përgjithshme. Sipas shkresës së sipërcituar kjo transfertë në radhë të parë duhet të përdorej për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura dhe pasi të jenë shlyer këto detyrime përdoret për shpenzime të tjera. Në vijim të VKB nr. 3 datë 30.01.2025 “Për një shtesë në VKB nr. 76, datë 19.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë së Shkodrës”, dhe detajimitt të fondeve sipas aktit normativ nr. 5 datë 19.12.2024 të Ministrisë së Financave, pas planifikimit të likuidimit të shumës 3,707,115 lekë për likuidim të borxheve, planifikimit të fondit 600,000 lek për instalim të matësve elektrik individual pranë tregut të fruta perimeve Sh.a. dhe 15,000,000 për realizim të investimit “Rikualifikim i godines se merkatos Rus”, bashkia Shkodër planifikon që vlera prej 40,000,000 të detajohet në transfertë për shpenzime për krijimin e kushteve për pushuesit në plazhin publik të menaxhuar për Sh.a. me NIPT M36924003O, si shtim kapitali për Sh.a.. Me evidencat e përkatëse nga AKB, bashkisë Shkodër në zbatim të VKM Nr. 649, datë 16.10.2024, do t’i lindë e drejta dhe përgjegjësia e menaxhimit të një numri prej më shumë se 10 stacione plazhesh për të cilat është e nevojshme të behët “mobilimi” me kushtet e përshtatshme për pushuesit dhe administrimi e tyre. Prandaj përmes fondeve në dispozicion dhe nevojës për krijim të kushteve për pushuesit në plazhin publik të menaxhuar, që do të transferohet për Sh.A me NIPT M36924003O, do të bëhet mobilimi i këtyre plazheve me rreth 1000 cada dhe 2000 shezlongë, vendosja e 1000 ml pedanave të aksesit për këto plazhe, vendosja e tualeteve publike, kufizuesve të plazhit dhe sinjalistikës me tabela, etj. për një funksionim të këtyre plazheve sipas VKM Nr. 649, datë 16.10.2024, si dhe kosto për administrimin (Staf) dhe logjistikë e administrimit për muajin e parë.

Sa më sipër referuar bazes ligjore: në mbështetje të nenit 54 germa 'dh' të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar; ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 " Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar; ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar; ligjit 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar; ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar; Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit"; të ndryshuar; VKM Nr. 649, datë 16.10.2024 "Për miratimin e rregullores "për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit" VKB nr. 76, datë 19.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë së Shkodrës", i ndryshuar; shkresa e Ministrisë së Financave nr. 17526/2 prot, dt. 23.12.2024 "Mbi zbatimin e Aktit Normativ nr.5, datë 19.12.2024", **propozojmë miratimin e këtij projekt vendimi për:**

Miratimin e shtesës së planit të buxhetit të Bashkisë Shkodër prej 40,000,000 lekë për krijimin e kushteve për pushuesit në plazhin publik të menaxhuar. Burim financimi është fondi shtesë i transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme sipas shkresës nr. 17526/2 Prot. dt. 23.12.2024 "Mbi zbatimin e Aktit Normativ nr. 5, datë 19.12.2024" të Ministrisë së Financave. Ky aktivitet do të përfshihet në programin P.AC141.Q3.O1.A15 "Krijimin e kushteve për pushuesit në plazhet publike të menaxhuara" përkatësisht transfertë 40,000,000 lekë Artikulli 604, për Sh.a. me NIPT M36924003O, si shtesë kapitali, sipas fishës bashkëngjitur:

Duke ju falenderuar!



Zv. Kryetar

Alban Peko

Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të
Qëndrueshëm Ekonomik

Behim Memo

Drejtoria e Turizmit

Renato Dumci

Nr. 36	P.AC141.Q3.O1.A15. Krijimin e kushteve për pushuesit në plazhet publike të menaxhuara	Programi AC141: Mbështetje për zhvillim ekonomik vendor dhe rural					
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit							
i. Situata							
Velipoja është një pasuri e rëndësishme natyrore e të gjithë bregdetit Shqiptar dhe ka nevojë të ruhet por dhe të zhvillohet në një mënyrë të qëndrueshme, duke dhënë shërbimet e duhura për vizitorët e shumtë. Sipërfaqja e madhe e plazheve në Velipojë kërkon dhe ndryshimet ligjore për menaxhimin e tyre kërkojnë krijimin e kushteve për pushuesit në plazhin publik të menaxhueshëm Velipojë. Kjo do të sjellë një rritje të aksesit për pushuesit, duke mobiluar këto plazhe publike, menaxhuar dhe administruar ato duke filluar kështu një aktivitet të ri të menaxhimit të hapësirave publike të administruar nga një ent publik. Ky plan është pjesë e një përpjekjeje më të gjerë për menaxhimin dhe administrimin e këtyre hapësirave publike, që përfshin investime për implementimin e ndryshimeve ligjore që synojnë përmirësimin e shërbimeve dhe kushteve për pushuesit duke kontribuar në zhvillimin e zonës si një destinacion turistik tërheqës. Për të siguruar që këto hapësira të funksionojnë në mënyrë efektive dhe të ofrojnë kushte të përshtatshme për pushuesit, Bashkia Shkodër ka parashikuar disa hapa kyç për investime dhe administrim. Bashkia Shkodër ka në pronësi të saj 100% sh.a. me NIPT M36924003O, e cila do të marrë të drejtën dhe përgjegjësinë e menaxhimit dhe administrimit të këtyre hapësirave të plazhit të menaxhueshëm, dhe me rritjen e kapaciteteve të saj mund të operojë në ushtrimin e funksionit të menaxhimit dhe administrimit të këtyre hapësirave të plazhit. Kjo do të bëjë që të kemi të njëjtin shërbim në të gjitha hapësirat e plazhit si dhe të kemi të ardhura të cilat sërish i dedikohen përmirësimit dhe shtimit të sipërfaqeve të menaxhuara nga bashkia. Me evidencat e përkatëse nga AKB, bashkisë Shkodër në zbatim të VKM Nr. 649, datë 16.10.2024, do t'i lindë e drejta dhe përgjegjësia e menaxhimit të një numri prej më shumë se 10 stacione plazhesh për të cilat është e nevojshme të behet "mobilimi" me kushtet e përshtatshme për pushuesit dhe administrimin e tyre. Duke qënë se është viti i parë për këtë aktivitet të ri planifikohet që të bëhen investime sa i përket mobilimit të plazheve që do të jenë të disponueshëm për menaxhim (Cadra, shezlonge, pedana aksesit, kufizues, tualete etj.) si dhe të kemi kosto për administrimin e plazheve publike të menaxhueshme (paga për punonjës, logjistike administrimi) që do të jenë të menaxhueshme nga bashkia përmes Sh.a. me NIPT M36924003O, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Prandaj përmes fondeve në dispozicion dhe nevojës për krijim të kushteve për pushuesit në plazhin publik të menaxhuar, që do të transferohet për Sh.A me NIPT M36924003O, do të behet mobilimi i këtyre plazheve me rreth 1000 cadra dhe 2000 shezlongë, vendosja e 1000 m pedanave të aksesit për këto plazhe, vendosja e tualeteve publike, kufizuesve të plazhit dhe sinjalistikës me tabela, etj. për një funksionim të këtyre plazheve sipas VKM Nr. 649, datë 16.10.2024, si dhe kosto për administrimin (Staf) dhe logjistikë e administrimit për muajin e parë. Bashkia Shkodër përmes Sh.a. me NIPT M36924003O do të krijojnë të gjitha kushtet e përshtatshme për sigurim të aksesit të publikut në shërbimet e ofruara nga një hapësirë plazhi.							
ii. Synimi i projektit							
Të sigurojë mobilimin e hapësirave të plazheve të menaxhueshme duke përmirësuar infrastrukturën e lehtë dhe shërbimet në plazhin Velipojë.							
iii. Aktivitetet kryesore të projektit							
- Identifikimi i nevojave për ndërhyrje për përmirësimin e aksesit në plazhe. - Konturimi i hapësirave publike me piketa dhe vendosje e tabelave informuese - Mobilimi i hapësirave të plazhit të menaxhueshme me cadra e shezlonge, pedana aksesit, shërbime higjienike etj. - Transferimi i fondit për Sh.a. me NIPT M36924003O për menaxhimin e dhe administrimin e këtij funksioni - Përgatitja e dokumentacionit tekniko-ligjor për procesin e prokurimit. - Kryerja e punimeve							
b) Rezultatet që prisni							
Ofrimi i shërbimeve cilësore për pushuesit në plazhet e menaxhuara nga Bashkia							
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt			
- Staf i Bashkisë - Bizneset turistike - Ndërmarrja e Shërbimeve Publike				- Bashkia Shkodër. - Sh.a. me NIPT M36924003O			
e) Shpenzimet e llogaritura							
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Krijimin e kushteve për pushuesit në plazhet publike të menaxhuara	40,000				40,000	
	Shuma	40,000				40,000	
f) Periudha e zbatimit		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:					
Prill – Shtator 2025		Drejtoria e përgjithshme e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, Drejtoria e Turizmit Institucioni likujdues: Bashkia Shkodër					